



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 631/2023
Datë: 31 gusht 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur më datë 31 gusht 2023, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Miratohet Raporti i Komisionit për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, KTAPSH/2023 i datës 20 korrik 2023 për transferimin e përhershëm të dy (2) prokurorëve në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore Mitrovicë si në vijim:
 1. Znj. Albana Parduzi prokurore në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, transferohet në mënyrë të përhershme në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.
 2. Znj. Ajtene Zoni, prokurore në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, transferohet në mënyrë të përhershme në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.
- II. Prokurorët e cekur në pikën 1 dhe 2 të paragrafit I të këtij vendimi do të transferohen në mënyrë të përhershme nga data 31 gusht 2023 si dhe për të njëjtit do të hartohen vendime të veçanta dhe të jenë pjesë e dosjes personale të tyre.
- III. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në Ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- IV. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen vendimet: KPK/Nr. 388/2023 i datës 23 maj 2023 dhe KPK/Nr. 378/2023 i datës 23 maj 2023.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.


Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Sekretariatit të KPK-së;
- NJSHPP;
- Arkivit të KPK-së.